



Tiranë më	protdate
Nr.	protnumber

RELACION
PËR
PROJEKTVENDIMIN
PËR MIRATIMIN E DOKUMENTACIONIT TË PUNËS TË
KOMISIONEVE TË QENDRAVE TË VOTIMIT, PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND

I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN
NË FUQI

Në mbështetje të nenit 19, pika 1, gërma “b” dhe “n” dhe pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen atij me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia nje shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Ky projektvendim ka objekt miratimit nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve të modeleve të vendimeve dhe dokumentacionit të punës që do të përdorë Komisioni i Qendrës së Votimit, për zgjedhjet për Kuvend.

Duke vlerësuar nga pikëpamja e objektit që trajton ky projektvendim, vlerësohet nga ana e ligjshmërisë së është në kompetencë të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për ta shqyrtuar.

II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Ky projektvendim është përgatitur dhe paraqitet për miratim, në kuadër të ushtrimit të kompetencës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, përcaktuar në nenin 19, pika 1, gërma “b” dhe “n” dhe pika 2, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, i cili drejton dhe mbikëqyr, drejtpërdrejtë ose nëpërmjet administratës së KQZ-së, veprimtarinë e administratës zgjedhore përgjatë zgjedhjeve dhe referendumëve.

Komisioni i Qendrës së Votimit, përgjigjet për administrimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve në qendrën e votimit sipas dispozitave të Kodit Zgjedhor dhe akteve nënligjore të nxjerra nga KQZ. Modelet e vendimeve dhe dokumentacionit të punës që do të përdorin Komisionet e Qendrave të Votimit, janë hartuar duke pasqyruar të gjitha elementët, faktet apo rubrikat që Kodi Zgjedhor përcakton si detyrim të KQV-së.

Neni 41, i Kodit Zgjedhor, parashikon detyrat e sekretarit të KQV-së, ku midis të tjerave përcaktohet se sekretari regjistron në Librin e Protokollit të Mbledhjeve, vendimet dhe procesverbalet e KQV-së dhe ua përcjell ato subjekteve të interesuara. Gjithashtu sekretari i KQV-së shënon vërejtjet e vëzhguesve (nëse ka) gjatë procesit të votimit, si dhe regjistron në një regjister të posaçëm të gjithë zgjedhësit që nuk e kanë emrin në listat përfundimtare dhe paraqiten për të votuar me vendim gjykatës, ku bashkëngjitur është vendimi i gjykatës.

Për shkak të problematikës së hasur të emërimit të anëtarëve të KQV-së propozohet të miratohet edhe “Listëprezenca e anëtarëve të KQV”. Ky model do të ndihmojë në mbarëvajtjen e punës dhe prezencës gjatë ushtrimit të detyrës të anëtarëve të emëruar, si dhe do të lehtësojë dokumentimin e pranisë së tyre për efekt të pagesës.



Gjithashtu paraqiten për miratim edhe 2 (dy) vërtetime për pajisjen e vëzhguesve të partive parlamentare për vulosjen e kutisë së votimit përpara fillimit të votimit dhe për mbylljen e votimit. Në përmbushje të detyrimeve të Kodit Zgjedhor nevojitet që KQV-të të japin kopje të procesverbaleve përfaqësuesve të këtyre partive. Por për shkak se teknikisht nga problematikat e hasura kopja e këtyre procesverbaleve është keqpërdorur në përmbajtje, me qëllim devijimin e kesaj problematike propozohet që këtyre subjekteve tu jepet një vërtetim i plotësuar nga kryetari dhe sekretari i KQV-së të cilët mbajnë përgjegjësi për të dhënat e plotësuara në këtë vërtetim.

Sa më sipër, Drejtoria e Administratës Zgjedhore ka konceptuar dhe i paraqit për miratim Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dokumentacionin e punës së KQV-së, si më poshtë:

a) Modelet e procesverbaleve

- Procesverbal “Për vulosjen e kutisë së votimit përpara fillimit të votimit”;
- Procesverbal “Për mbylljen e kutive të votimit”;
- Procesverbal i mbylljes së qendrës së votimit një ditës para datës së zgjedhjeve me etiketën e sigurisë;
- Procesverbal i marrjes në dorëzim të qendrës së votimi nga KQV në ditën e zgjedhjeve;
- Procesverbal i pezullimit të votimit;
- Procesverbal i rifillimit të votimit;
- Procesverbal “Vërejtje nga vëzhguesit”.

b) Modelet e vendimeve

- Vendim “Përcaktimin e detyrave të anëtarëve të KQV”;
- Vendim “Për hapjen e votimit”;
- Vendim “Për largimin e personave të caktuar nga mjediset e qendrës së votimit”;
- Vendim “Për pezullimin e votimit”;
- Vendim “Për kërkimin e ndihmës nga Policia e Shtetit për rivendosjen e rendit në qendrën e votimit”;
- Vendim “Për largimin e forcave të policisë pas rivendosjes së rendit në qendrën e votimit”;
- Vendim “Për mbylljen e votimit”;
- Vendim “Përcaktimin e numrit të personave që kanë votuar në qendrën e votimit”.

c) Modelet e dokumentacionit të punës

- Libri i Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së;
- Regjistri i Posaçëm i Zgjedhësve.

ç) Modelet e vërtetimeve/deklaratave

- Deklaratë e personit që ndihmon një zgjedhës;
- Shënime për fletë votimi të dëmtuara;
- Për pajisjen me vërtetim të vulosjes së kutisë së votimit, vëzhguesve të partive parlamentare;
- Për pajisjen me vërtetim të mbylljes së votimit, vëzhguesve të partive parlamentare;
- Vërtetim për identifikimin e zgjedhësit me nënshkrim pa shenja Gishtërinjsh;
- Listëprezencë e anëtarëve të KQV-së.

Modelet e vendimeve dhe dokumentacioni i punës së KQV kodifikohen sipas kategorive të tyre nga sekretari i përgjithshëm i KQZ.

Bashkëlidhur projektvendimit janë renditur modelet e sipërcituara.

Për sa më sipër në këtë relacion, Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, brenda kompetencave të veta dhe në respektim të detyrimeve e afateve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, i paraqitet për shqyrtim dhe miratim projektvendimi “Për miratimin e dokumentacionit të punës të Komisioneve të Qendrave të Votimit, për zgjedhjet për Kuvend”.

Erion META - Drejtorja e Administratës Zgjedhore

Pavlina DOÇAJ - Drejtorja e Ligjshmërisë

Majlinda ÇELMETA - Sekretar i Përgjithshëm (në mungesë dhe me urdhër)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: DD MM VVVV

Nr: 000-000

Ora: HH:MM

PROJEKTVENDIM
PËR
MIRATIMIN E DOKUMENTACIONIT TË PUNËS TË KOMISIONEVE TË QENDRAVE
TË VOTIMIT, PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND

Në mbështetje të nenit 19, pika 1, gërma “b” dhe “n” dhe pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOS:

1. Miratimin e dokumentacionit të punës së Komisioneve të Qendrave të Votimit, për zgjedhjet për Kuvend, si vijon;

a) Modelet e procesverbaleve

- Procesverbal “Për vulosjen e kutisë së votimit përpara fillimit të votimit”;
- Procesverbal “Për mbylljen e kutive të votimit”;
- Procesverbal i mbylljes së qendrës së votimit një ditës para ditës së zgjedhjeve me etiketën e sigurisë”;
- Procesverbal i marrjes në dorëzim të qendrës së votimi nga KQV në ditën e zgjedhjeve;
- Procesverbal i pezullimit të votimit;
- Procesverbal i rifillimit të votimit.
- Procesverbal “Vërejtje nga vëzhguesit”.

b) Modelet e vendimeve

- Vendim “Përcaktimin e detyrave të anëtarëve të KQV”;
- Vendim “Për hapjen e votimit”;
- Vendim “Për largimin e personave të caktuar nga mjediset e qendrës së votimit”;

- Vendim “Për pezullimin e votimit”;

Data: DD MM VVVV Nr: 00 00
Ora: HH:MM



Për miratimin e dokumentacionit të punës të Komisioneve të Qendrave të Votimit, për zgjedhjet për Kuvend

- Vendim “Për kërkimin e ndihmës nga Policia e Shtetit për rivendosjen e rendit në qendrën e votimit”;
- Vendim “Për largimin e forcave të policisë pas rivendosjes së rendit në qendrën e votimit”;
- Vendim “Për mbylljen e votimit”;
- Vendim “Përcaktimin e numrit të personave që kanë votuar në qendrën e votimit”.

c) Modelet e dokumentacionit të punës

- Libri i Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së;
- Regjistri i Posaçëm i Zgjedhësve.

ç) Modelet e vërtetimeve/deklaratave

- Deklaratë e personit që ndihmon një zgjedhës;
- Shënime për fletë votimi të dëmtuara;
- Për pajisjen me vërtetim të vulosjes së kutisë së votimit, vëzhguesve të partive parlamentare;
- Për pajisjen me vërtetim të mbylljes së votimit, vëzhguesve të partive parlamentare;
- Vërtetim për identifikimin e zgjedhësit me nënshkrim pa shenja Gishtërinjsh;
- Listëprezencë e anëtarëve të KQV-së.

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për kodifikimin e modeleve sipas kategorive të dokumentacionit.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI